

Raporti Vjetor 2016

nga Sektori i Buxhetit, Financës dhe Shërbimeve Mbeshtetese

I.HYRJE

Në zbatim të organikës së institucionit, e cila do të paraqitet më poshtë, Instituti i Studimit të Krimeve të Komunizmit është strukturuar në dy drejtori dhe ne nje sektor: Drejtoria e Studimeve Shkencore, Drejtoria e Arkives dhe Sektori i Buxhetit, Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse. Struktura, marrëdhëniet dhe detyrat e këtyre drejtorive, rregullohen përveç legjislacionit dhe akteve nënligjore në fuqi edhe nga rregullorja e brendshme e institucionit, e cila ka përcaktuar në mënyrë të detajuar funksionet, përgjegjësitë dhe procedurat për kryerjen e veprimtarisë së secilës prej këtyre drejtorive dhe sektorit.

Emerimi personelit te institucionit, eshte bere ne zbatim te Ligjit Nr.10242 date 25.02.2010 “Per Institutin e Studimeve per Krimet dhe Pasojat e Komunizmit ne Shqiperi” neni 13 i tij si dhe ne baze te VKM-se nr 191, date 23.02.2011 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Institutit të Studimit të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit në Shqipëri”, organika e institucionit tonë, ka 15 punonjes.

Për sa më sipër dhe në zbatim të Ligjit Nr. 10468, datë 18.12.2011 “Për buxhetin e shtetit të vitit 2015”, numri i punonjësve të institucionit të ISKK për vitin 2016, ka qenë 15 punonjës.

ORGANIKA E STRUKTURA E INSTITUCIONIT TË STUDIMEVE PER KRIMET E PASOJAT E KOMUNIZMIT NE SHQIPERI

POZICIONI	NUMRI
I. DREJTORI EKZEKUTIV	1
SEKRETAR/ARKIVIST	1
II. DREJTORIA E ARKIVES/NENDREJTORI	(4)
DREJTOR DREJTORIE/NENDREJTOR	1
SPECIALIST	3
III. DREJTORIA E STUDIMEVE	(5)
DREJTOR DREJTORIE	1
SPECIALIST	4
IV. SEKTORI I BUXHETIT, FINANCËS DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE	(4)
PERGJEGJES SEKTORI	1
SPECIALIST	2
SHOFER	1
PUNONJËS GJITHSEJ	15

II. FAQJA E INTERNETIT

Adresa e internetit te ISKK eshte, www.iskk.gov.al, është ndërtuar me krijimin e institucionit, në gjuhën shqip dhe anglisht.

I rëndësishëm për t'u evidentuar është fakti se në adresën e email-it info@iskk.gov.al të gjithë të interesuarit mund të drejtojnë pyetje dhe të dergojnë informacion që do të ndihmonte edhe me tej punën studimore të institutit.

III. BUXHETI

Buxheti mbetet i rëndësishëm për realizimin e veprimtarisë së institutit. Në funksion të këtij objekti, buxheti i miratuar për institucionin tonë, në volumnin e tij të përgjithshëm, ka qenë si fillim 28.1 milion lekë. Megjithatë, institucioni ynë ka bërë të mundur që nëpërmjet përdorimit me rigorozitet të buxhetit të miratuar, të realizojë tërësisht detyrimet dhe angazhimet e tij.

Megjithëse totali i shpenzimeve është realizuar në masën 92.43% aspekt ky që tregon se realizimi i shpenzimeve është në nivelin maksimal, megjithatë mosrealizimi është me i ndjeshëm në shpenzimet Operative . Shpenzimet kapitale të miratuara prej 1.0 milion lekësh janë realizuar në masën 40.5%. U krijua një fond biblioteke në masën 124 mijë leke pasi pasja e Biblioteke është e rëndësishme për Drejtorinë e Studimeve, u blenë pajisje ndihmese për kompjuterat që përdoren për konferencat e mbajtura nëpër shkollat e mesme, si dhe në masën 84.880 u blenë fikse zjarri për zyrat e ISKK. Shfrytëzimi në këto masa i këtij fondi plotësoi disa nga kërkesa e tyre për libra për vitin 2016, dhe kërkesa të tjera të paraqitura në

Artikulli	Emërtimi	Plani Vjetor (në mijë lekë)	Realizimi vjetor (në mijë lekë)	Realizimi vjetor në %
600	Paga	14,430	14,197	98.39%
601	Sigurime shoq. & shëndet.	2,170	2,143	98.80%
602	Mallra e shërbime të tjera	10,500	9,228	87.89%
600-606	Shpenzime korente	27,100	25,569	94.35%
231	Shpenzime kapitale	1,000	405	40.5%
Totali i shpenzimeve		28,100	25,974	92.43%

fillim të vitit 2016 nga të gjithë sektorët e drejtorisë së ISKK.

Mbështetur në treguesit e realizimit të buxhetit të Institutit tonë, për periudhën Janar-Dhjetor 2016, situata buxhetore (plani vjetor dhe realizimi faktik, në lekë e përqindje) paraqitet në tabelat e mësipërme:

Gjithashtu, në tabelën e mëposhtme, evidentohet pesha e shpenzimeve sipas artikujve në raport me totalin e shpenzimeve:

Artikulli	Emërtimi	Realizimi vjetor (në mijë lekë)	Realizimi në raport me totalin e shpenzimeve
600	Paga	14,197	54.66%
601	Sigurime shoq. & shëndet.	2,144	8.25%
602	Mallra e shërbime të tjera	9,228	35.53%
231	Shpenzime kapitale	405	1.56%
	Totali i shpenzimeve	25,974	100%

Pergjegjes Sektori

Zoica GRACI

Tirane me 07.02.2017